REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I MINISTRAVE**
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

# VENDIM

Nr. 20, datë 12.07.2019

**PËR**
**RISHIKIMIN E KUSHTEVE PËR OBJEKTIN:**
**"STRUKTURA SHËRBIMI ME FUNKSION MAGAZINIMI DHE TREGTIMI 1-2 KATE "MALL OF TIRANA" ME VENDNDODHJE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KASHAR, BASHKIA TIRANË"**

Në mbështetje të Neneve 27, 28 dhe 48, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjektit "Concord Investment" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rishikimit të kushteve për objektin: "Struktura shërbimi me funksion magazinimi dhe tregtimi 1-2 kate "Mall of Tirana" me vendndodhje në Njësinë Administrative Kashar, Bashkia Tiranë", me subjekt zhvillues shoqërinë "Concord Investment" sh.p.k, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 7, datë 22.02.2017.

2. Harta e planvendosjes së strukturave për Fazën 1 (A dhe B), bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 7, datë 22.02.2017, zëvendësohet me hartën e planvendosjes së strukturave bashkëlidhur këtij Vendimi.

3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I MINISTRAVE - KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MINISTËR I LINJËS

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**BELINDA BALLUKU**

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**